



Njoftim publik

Në Drejtorinë e Urbanizmit të Komunës së Prishtinës është dorëzuar kërkesa nr. 05nr.350/02-225573/21 dt.22.10.2021, e pronarëve: Ragip Selimi, Edis, Izet, Uzejir Çollakoviç, Luan Rexha, Sefedin Statovci, Naim Konjufca, Gjuzide, Drita Kllokoçi,, Valbone, Naser dhe Fatmir Mërkoja nga Prishtina dhe Investitori N.P.N. “Driloni Com”, me seli në Malishevë, e përfaqësuar nga Dalip Gashi, përmes së cilës kërkohet të përcaktohen kriteret e kushteve ndërtimore, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor, për ndërtimin e ndërtesës shumë banesore me afarizëm, etazhitet 2B+S+P+17, në kuadër të Planit Rregullues "Muhaxhirët" në Prishtinë, gjegjësisht në kuadër të Tërësisë Hapësinore B, Nen tërësia B-1, Blloku urban “b_01”, më konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr. 6926-0;6927-0;6928-0;6929-0;6930-0;6931-0;6932-0;6933-0, ZK Prishtinë. Është prezantuar edhe projekt propozimi-zgjidhja urbane, për ndërtimin e ndërtesës shumë banesore me afarizëm.

Bazuar në nenin 18, pika 2 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt.31.05.2012, kjo drejtori njofton publikun dhe mundëson komentet për kërkesën e dhënies së lejes ndërtimore. Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data **04.11.2021** deri më **18.11.2021**, në E-mail adresën: urbanizmprishtine@rks-gov.net

Kushtet e propozuara të ndërtimit: Ndërtesë shumë banesore me afarizëm	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Tokë ndërtimore/ e propozuar Tokë ndërtimore
b. Vija rregulluese	E përcaktuar me profilin e rrugës publike sipas Planit Rregullues “Muhaxhirët”
c. Vija ndërtimore	E përcaktuar me profilin e planifikuar të rrugës publike nga vija rregulluese
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	2B+S+P+17/ E përcaktuar me vijën ndërtimore;
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësorë dhe të pasmë të parcelës kadastrale.	Vija ndërtimore-ana lindore; 13.20m’/60.67m’-ana perëndimore; 7.20m’-8.75m’ /25.0-29.0m’ ana jugore
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHP)	ISHP=40%
g. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese mbi tokë në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISPN)	ISPN=4.0
h. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHGJ)	ISHGJ=30%, duke përdorur kulme dhe etazhë e gjelbëruar
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHN)	ISHPN=60%
j. Numri i hapësirave për vend parkime të automjeteve	sipas planifikimeve në fuqi
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	/
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po - <input checked="" type="checkbox"/> Jo - <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/>	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe sesa zona përreth? Po - <input type="checkbox"/> Jo - <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/> Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në zona të mbrojtura, zona të veçanta ose zona të veçanta të mbrojtura? Po - <input type="checkbox"/> Jo - <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/> Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit administrativ 06/2017, dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigje njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet tuaja duhet të përfshihet numri i kërkesës të shënuar më lartë
Nënshkrimi i Zyrtarit:

